

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. B nga P me mbrojtësin me autorizim av. ..nga P, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.150/2015, të datës 27.01.2015, të cilën e përfaqësonte Prokurori Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij më datën 07.09.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S. B**, nga i ati R, e ëma E e lindur A i lindur më dt.në P, ku dhe jeton, ..., ka të kryer shkollën e mesme i pa punë, i martuar-baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i dënuar ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datën 20.11.2014, rreth orës 09:15 minuta në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Gj, i pandehuri ..me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës S. M nga Gj, atë mënyrë që për deri sa e dëmtuara ishte në ...dhe priste para derës së ordinancës për të u injektuar, i pandehuri fillimisht krijon një tollovi të njëjtës i jep përparësi dhe në atë moment shfrytëzon rastin dhe nga gjepi i të dëmtuarës nxjerr portofolin me .. € brenda dhe dokumentacionin e identifikimit dhe pas kësaj me të shpejtë largohet nga vendi i ngjarjes dhe ikë në drejtim të pa njohur ashtu që parat në shumë prej 30€ i përvetëson për vete ndërsa portofolin me dokumentacion e hedh në një vend të pa njohur për të, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta të dëmtuarës i shkakton dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer vepër penale, Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-ës, Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit, në bazë të neneve 4, 41, 46, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit S. B, i shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gj.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-s, i akuzuari S. B, obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzetë e pesë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndorë për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjer si në pikëpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor dhe ka propozuar që pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe shtjellimit të provave i akuzuari S. B të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë çështje penale.

Prokurori i shtetit Ismet Ukshini deklaron: Pas negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt. 22.06.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin ku i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par. 21 të KP që këtë marrëveshje dhe dënim ta aprovojë.

Mbrojtësi i të pandehuritdeklaron: pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim dhe pas negociimit lidhur me arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kemi arrit marrëveshje me PTH në Gjilan e përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi. Nga gjykata kërkojmë që me rastin e pranimit të kësaj marrëveshje të merr parasysh edhe rrethanat lehtësuese për të mbrojturin tim siç janë pranimi i fajësisë, i njëjti është penduar dhe asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Andaj nga të cekurat më lartë i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje dhe dënimin ta pranojë duke qenë se e njëjta është lidhur në përputhmë me dispozitat e KPP .

I pandehuri deklaron: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, më vjen keq për rastin që ka ndodhur dhe nuk kam tjetër çka të shtoj.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i akuzuari dhe mbrojtësi i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të pandehurit ti shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale. Bazuar në nenin 453 të KPPRK-s gjykata e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit. Përfaqësuesi i akuzës, i akuzuari dhe mbrojtësi me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.137/2015 të datës 07.09.2017**

**Sekretarja Juridike,
Igballe Azemi d.v**

**Gjykatësi i vetëm gjykues,
Behar Ymeri d.v**

KËSHILLA JURIDIKE: Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3. të KPPRK-s.